



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Procesverbal - Tipi i kontrates - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS – “Sherbime dhe mrembajtje ne pyje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 77200000-2 Sherimet pyjore

VLERA E FONDIT LIMIT – 3 983 724 (tre milion e nenteqind e tetedhjet e tre mije e shtateqind e njezet e kater) **Leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite të fundit financiare (2022, 2023, 2024), që tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuar, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pikë 3, e LPP, si dhe nenin 43, pikë 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmbushja e këtij kriteri i shërbenë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së për llogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës ose fature tatimore të shitjes, të potësuar asipas legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen data, shumat dhe shërbimet e realizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik si deshmi duhet të paraqesë vetem fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të disponojë Stafi Teknik si më poshtë:

- **Inxhinier Agromjedisi 1(nje)**, i licencuar dhe i pajisur me certifikatën e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) nga organet përgjegjëse
- **Inxhinier pyjesh 1(nje)**, i licencuar nga organet përgjegjëse
- **Agronom 1 (nje)**

Të gjithë dokumentat e mësipërme duhen vërtetuara këto për secilin specialist me diplomë, kontratë pune dhe të jenë të punësuar për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- 1 (një) inxhinier agromjedisi i licencuar dhe i pajisur me certifikatën e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) nga organet përgjegjëse.

Argumenti: Objekti i kontratës është “Shërbim dhe mirëmbajtje në pyje” (pyllezim) me Pishë të Zezë (*Pinus nigra*), që përfshin ndërhyrje në tokë, mbjellje, përgatitje terreni dhe shërbime kulturore në një ekosistem natyror të ndjeshëm. Për këtë arsye, përfshirja e një inxhinieri agromjedisi të licencuar garanton që punimet të kryhen në përputhje me standardet mjedisore dhe me masat e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Ky kriter mbështetet në: Neni 58, pika 2, shkronja “b” e Ligjit nr. 162/2020, që lejon autoritetin kontraktor të kërkojë “kapacitete teknike dhe profesionale të përshtatshme për zbatimin e kontratës”; Neni 39, pika 3 e VKM nr. 285/2021, që përcakton se kriteret

t e kualifikimit duhet të lidhen ngushtë me natyrën e punës dhe të jenë të domosdosh me për cilësinë e zbatimit. Prandaj, kërkesa për një inxhinier agromjedisi të licencuar me çertifikate per VNM është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe siguron standarde të larta mjedisore dhe teknike në zbatimin e projektit

- 1 (një) inxhinier pyjesh i licencuar nga organet përgjegjëse,

Argumenti: Ky kriter është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe lidhet ngushtë me natyrën e kontratës për “Sherbim dhe mirembajtje ne pyje” (pyllezim). Punimet e planifikuara përfshijnë mbjellje, përgatitje terreni, monitorim dhe shërbime pas mbjelljes, të cilat kërkojnë ekspertizë profesionale nga një Inxhinier pyjesh i licencuar; Baza ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 58, pika 2, shkronja “b” – që i jep autoritetit kontraktor të drejtën të kërkojë kapacitete teknike dhe profesionale të përshtatshme për zbatimin e kontratës; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 39, pika 3 – që përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të lidhen drejtpërdrejt me natyrën dhe qëllimin e kontratës; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 29.04.2022, *“Për rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve”, Certifikate ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave” pika c, dhe d* – i cili parashikon se veprimtaritë profesionale në fushën e pyjeve mund të kryhen vetëm nga persona të kualifikuar dhe të pajisur me çertifikatë eksperti nga organet përgjegjëse të pyjeve

- 1 (një) Agronom

Argumenti: Ky kriter është në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën teknike të kontratës për “Sherbim dhe mirembajtje ne pyje” (pyllezim), ku kërkohet njohuri profesionale mbi fidanat, tokën, përgatitjen e saj dhe mbijetesën e bimësisë. Baza ligjore: Ligji nr. 162/2020, neni 58, pika 2, shkronja “b” – parashikon mundësinë e kërimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale të përshtatshme për kontratën; VKM nr. 285/2021, neni 39, pika 3 – përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe qëllimin e kontratës; Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, që thekson rëndësinë e specialistëve të fushës së agronomisë në proceset që lidhen me përgatitjen e tokës, mbjelljen dhe zhvillimin e bimësisë.

Të gjithë dokumentat e mesiperme duhen vërtetuara këto për secilin specialist me diplomë, kontrate pune dhe te jene te punesuar per periudhen e 3 (tre) muajve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesmarres duhet te kete 10 (dhjete) punonjes te thjeshte.

Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore vërteton një numër mesatar prej 10 punonjës përperiudhën e 3 (tre) muajve të fundit data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumenti: Ky dokument ka për qëllim të dëshmojë kapacitetin e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën me burime njerëzore të mjaftueshme dhe të qëndrueshme. Baza ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 58, pika 2, shkronja “b”, që parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë prova për kapacitete teknike dhe profesionale të mjaftueshme për përmbushjen e kontratës; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 3, që përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me objektin dhe qëllimin e kontratës;

2.3.3 Operatori ekonomik pjesmarres të ketë minimumi 5 punonjës të pajisur me certifikatë të kopshtarie (ku të jete nr i Amzes dhe lista e moduleve sipas udhezimit të MFE-se, Nr.16 date 26/04

Argumenti: Ky kriter garanton se operatori ekonomik zotëron staf të kualifikuar dhe të certifikuar profesionalisht për zbatimin e punimeve të mirëmbajtjes së gjelbërimit, pyllëzimit dhe e përkujdesjes bimë, duke siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri teknike në realizimin e kontratës. Baza ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 58, pika 2, shkronja “b” – që i jep autoritetit kontraktor të drejtën të kërkojë kapacitete teknike dhe profesionale të përshtatshme për objektin e kontratës; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 39, pika 3 – që përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe qëllimin e kontratës;

2.3.4 Drejtues mjetesh 1 (një) shofer, që të ketë dëshmi aftësie profesionale për automekinist , 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Të vërtetuara këto për secilin punonjës me kontratë pune dhe të jenë punësuar për periudhën 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumenti: Ky kriter është i domosdoshëm, i arsyetuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për garantimin e sigurisë teknike dhe humane gjatë zbatimit të kontratës. Baza ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 58, pika 2, shkronja “b” – për kërkesën e kapaciteteve teknike dhe profesionale të përshtatshme për objektin e kontratës; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 39, pika 3 – kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura me natyrën dhe qëllimin e kontratës;

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponoj mjete:

- Kamioncinë 2 (dy)

- Kamion 1 (nje)
- Minieskavator 1 (nje)

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 10) .

Argumenti: Ky kriter garanton se operatori ekonomik disponon kapacitete logjistike dhe me kanike të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, duke siguruar realizimin e punimeve në mënyrë efektive, të sigurt dhe brenda afateve të përcaktuara. Baza ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 58, pika 2, shkronja “b”, që përcakton se autoriteti kontraktor mund të kërkojë prova për mjetet teknike dhe pajisjet që operatori ka në dispozicion; VKM n r. 285, datë 19.05.2021, neni 39, pika 3 – që përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e kontratës;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Komisioni për Hartimin e kriereve (për pyllëzimin)

Ing. Ded Lleshi

Ing. Aleks Ndreka

Ing. Zamir Alija